VENDIM
Nr. 183, datë 13.11.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "*GREENTECH ENERGY SYSTEMS*" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 10, pika 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.11.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "*Greentech Energy Systems*" sh.p.k., si dhe relacionin nr. 119/2 prot., datë 6.11.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "*Greentech Energy Systems*" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "*Greentech Energy Systems*" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155 prot., datë 2.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

-Shoqëria "*Greentech Energy Systems*" sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 18.4.2016, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

-Aplikimi i shoqërisë "*Greentech Energy Systems*" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d" "e", "f" dhe "g") është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8; germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

germa "c" (të dhëna për aplikuesin) plotësuar pjesërisht;

Shoqëria duhet të plotësojë edhe deklaratën për kryerjen e pagesës së aplikimit për licencim/njohje për licencim sipas llojit të veprimtarisë.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, është plotësuar nga aplikanti, si më poshtë:

Neni 9, pika 2:

germat: "a"/"b" (akti i themelimit/statuti). Plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE, në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores, statutin dhe aktin e themelimit në origjinal ose fotokopje të noterizuar/njësuar me origjinalin.

germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan, për shoqërinë "*Greentech Energy Systems*" sh.p.k., dhe administratorin e saj, duke qenë se për këtë të fundit shoqëria nuk ka depozituar të tillë.

germa "e" (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik-elektrik. Plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka përcjellë në ERE strukturën e organizimit të shoqërisë, të ndarë në departamentet përkatëse, por vihet re se ky dokument nuk mban nënshkrimin e administratorit të saj e as vulën. Po ashtu vihet re se mungon edhe licenca e drejtuesit teknik-elektrik.

Në vijim shoqëria do të depozitojë në ERE strukturën e organizimit të nënshkruar dhe vulosur, si dhe të përcjellë në ERE licencën për drejtuesin teknik-elektrik.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal

Neni 9, pika 3:

germa "b" (bilanci financiar të tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria "*Greentech Energy Systems*" sh.p.k. ka depozituar pasqyrat financiare në formatin fotokopje dhe në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores, do t'i kërkohet të depozitojë origjinal ose fotokopje të noterizuar/njësuar me origjinalin. Gjithashtu duhet të depozitojë në ERE edhe pasqyrat financiare për vitin 2017, duke qenë se është konstatuar si mungesë.

germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Pa plotësuar. Shoqëria në vijim do të paraqesë në ERE dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të saj.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, është plotësuar nga aplikanti, si më poshtë:

Neni 9, pika 4.8, germat "a"/"d" (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në gwh / sipas viteve). Pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur sa kërkohet nga kjo pikë e rregullores, por do t'i kërkohet t'i paraqesë në vijim.

germa "b" (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti). Pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur dokumente në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, por në vijim do t'i kërkohet t'i depozitojë në ERE.

germa "c" (Lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur). Pa plotësuar. Sa konstatohet, shoqëria nuk ka ushtruar më parë veprimtari në fushën e energjisë dhe si e tillë nuk mund të disponojë kontrata të realizuara më herët. Megjithatë do t'i kërkohet shoqërisë të bëjë plotësimin e saj qoftë edhe në mënyrë deklarative, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "*Greentech Energy Systems*" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti